

## Përshkrim i shkurtër i projektit

---

### Emri i projektit

Hekurudha Shqiptare

### Vendi

Shqiperi

### Numri identifikues i Projektit

48466

### Sektori i Biznesit

Transport

### Sektori Publik

### Data e planifikuar e Bordit

2 Nentor 2016

### Statusi

Ka kaluar miratimin e pare, ne pritje te miratimit perfundimtar.

**Publikimi i PSD (Dokument Permbledhës i Projektit):** 21 Qershor 2016

## Përshkrimi i Projektit

BERZH po konsideron dhënien e nje huaje sovrane për Republikën e Shqipërisë me përfitues Hekurudhën Shqiptare (HSH ose Shoqëria). Kjo hua do të financojë: i) rehabilitimin dhe përmirësimin e standarteve për 34.7 km hekurudhë midis Terminalit të Transportit Publik të Tiranës (TTP) dhe qytetit të Durrësit dhe ii) ndërtimin e 7.4 km linjë hekurudhore midis Terminalit të Transportit Publik të Tiranës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA). Huaja e dhënë nga Banka do të përdoret për të bashkë-financuar punimet dhe mbikqyrjen e punimeve që lidhen me Projektin.

## Objektivat e Projektit

Projekti është pjesë e Route 2 të Rrjetit Kryesor të Ballkanit Perendimor që lidh qytetet e Podgoricës në Malin e Zi dhe Vlorës në Shqipëri dhe është krijuar si një zgjatim orientues i Rrjetit të Transportit Trans-European (TEN-T) në Rrjetin Kryesor hekurudhor të Ballkanit Perendimor. Projekti do të mbështesë zhvillimin ekonomik të

Shqipërisë dhe do të kontribuojë në integrimin rajonal të saj duke përmirësuar lidhjen e qyteteve të saj kryesore me Portin e Durrësit dhe TIA-n.

## Ndikimi në Tranzicion

Projekti do të përfshijë reforma sektoriale dhe masa përforcuese institucionale në fushat e mëposhtme:

- 1. Menaxhimi i Aseteve dhe Tarifave të Aksesit Hekurudhor:** zhvillimi i një Plani të Menaxhimit të Aseteve i cili do të përfshijë shqyrtimin e gjendjes së asetëve të Shoqërisë si dhe vlerësimin e të gjitha kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit. Kjo do të mundësojë një përdorim efektiv të burimeve të mirëmbajtjes dhe do të ofrojë një bazë transparente për përlogaritjen e tarifave të aksesit hekurudhor në përputhje me udhëzimet e Bashkimit European (BE) për sektorin hekurudhor, si dhe do të mundësojë hyrje të lirë dhe transparente të palëve të treta në rrjet;
- 2. Kontabiliteti sipas Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS):** përmirësimi i sistemeve kontabël dhe të raportimit të Shoqërisë do t'i mundësojë Shoqërisë përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje të plotë me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, në vijim;
- 3. Ekonomia e Gjelbër:** shërbimet hekurudhore të cilësisë së lartë janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve të transportit dhe reduktojnë emetimin e CO<sub>2</sub> në përputhje me objektivat e politikave lokale dhe të BE që lidhen me transportin.

## Informacion për Klientin

MINISTRIA E FINANCAVE

Huamarrësi është Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Klienti dhe përfituesi i Projektit është Hekurudha Shqiptare e cila është përgjegjëse për infrastrukturën hekurudhore dhe operimin e trenave.

## PËRMBLEDHJA E FINANCIMIT TË BERZH

EUR 34,500,000.00

Hua sovrane për Republikën e Shqipërisë

## Kostoja Totale e Projektit

EUR 86,400,000.00

## Përmbledhja Sociale dhe Mjedisore

Kategorizuar B (2014 ESP). Rehabilitimi dhe përmirësimi i linjës hekurudhore ekzistuese me një gjatësi prej 34.7 km mes Tiranës dhe Durrësit dhe ndërtimi i 7.4 km linjë të re hekurudhore që lidh TTP-n dhe TIA-n mund të përfshijë çështje specifike mjedisore dhe sociale që do të adresohen përmes masave të duhura parandaluese.

Proçesi i Vlerësimit Mjedisor dhe Social nga konsulentë të pavarur do të përfshijë auditimin mjedisor dhe social të operacioneve ekzistuese, menaxhimit të sistemeve dhe shqyrtim të Vlerësimit të Impaktit Mjedisor që është përgatitur për Projektin.

Vlerësimi i Impaktit Mjedisor tregon se shtrirja e linjës së re hekurudhore do të kërkojë shpronësime por jo shëmbjen e ndërtesave ekzistuese. Proçesi i shpronësimit dhe masat për rregullimin e aksesit dhe impaktin e mundshëm ndaj pronarëve të tokave bujqësore dhe atyre informalë (përfshirë ndikimin në sistemet e ujitjes) do të duhet të verifikohet gjatë proçesit të auditimit për të siguruar nëse janë plotësuar apo jo standartet e PR5.

Çështjet që lidhen me sigurinë e komunitetit aktualisht përfshijnë përdorimin e pa autorizuar të kryqëzimeve, me të paktën 15 të tilla që janë identifikuar se përdoren përgjatë hekurudhës në itinerarin aktual. Rregullimi i aksesit për këmbësorët dhe automjetet do të konsiderohet gjatë auditimit pasi linja e re por edhe ajo e përmirësuar do të jenë të gardhuara.

Përputhshmëria e Shoqërisë me Politikën dhe Standartet e Përfomancës të BERZH është aktualisht duke u vlerësuar dhe çdo mospërputhje do të adresohet në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social. Dokumenti Përmbledhës i Projektit do të përditësohet kur të bëhen të ditura konkluzionet e proçesit të auditimit.

## **Bashkëpunimi Teknik**

Si pjesë e Projektit janë parashikuar edhe pikat e mëposhtme të Bashkëpunimit Teknik:

1. Mbikqyrja e punimeve;
2. Mbështetje në zbatimin e Projektit;
3. Forcimi institucional duke asistuar në përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Aseteve dhe Tarifave të Aksesit Hekurudhor në Shqipëri;
4. Rritje të kapaciteteve me qëllim përmirësimin e sistemeve kontabël të HSH në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## **Informacion mbi Kontaktin e Shoqërisë**

Z. Genc Alizoti, Administrator

[gencializoti@gmail.com](mailto:gencializoti@gmail.com)

+355 522 22037

+355 522 22037

Hekurudha Shqiptare Lagjia nr. 3, Egnatia Street Durres, Albania

## **Mundësi biznesi**

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni shoqërinë, klientin

## **Pyetje të përgjithshme**

Për pyetje mbi projektin e BERZH që nuk lidhen me prokurimet:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

## **Politika e Informimit Publik (PIP)**

PIP përcakton mënyrën se si BERZH jep informacion dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyrë që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i PIP mund të gjendet në:

<http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

## **Mekanizmi i Ankesave për Projektet (MAP)**

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankimimeve për Projektet (MAP) për të ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata në lidhje me projekte të financuara nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që do të mund të shkaktojnë efekte negative.

Rregullat e Procedures se MAP mund te shihen ne:

<http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Cdo ankesë sipas Mekanizmit të Ankesave për Projektet duhet të dërgohet jo më vonë se 12 muaj nga akordimi i fundit i fondeve të BERZH. Ju mund të kontaktoni për ndihme punonjës in e MAP në [pcm@ebrd.com](mailto:pcm@ebrd.com) ose zyrën përkatëse të BERZH në vendet ku ajo ushtron aktivitetin, nëse jeni të paqartë mbi periudhën brenda së cilës duhet të dorëzohet ankesa.